

VENDIM
Nr.472, datë 2.7.2011

PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE BUXHETORE PËR VITIN 2011

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 16 e 40 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 10 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpenzimet e personelit, të miratuara në buxhetin e vitit 2011 për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme, përbëjnë kufirin maksimal të lejuar për t’u përdorur për çdo njësi shpenzuese për punonjësit e miratuar me aktet përkatëse, ligjore dhe nënligjore. Për disiplinimin e këtyre shpenzimeve, për vitin 2011, zbatohen këto masa:

a) Çdo funksion në administratën publike, i miratuar në organikë dhe i paplotësuar ende, të ngrihet deri në ristrukturimin e institucioneve, në përputhje me standardet e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Institucionet që kanë miratuar strukturën pas këtij vendimi apo që janë krijuar rishtazi, në zbatim të akteve, ligjore dhe nënligjore, vazhdojnë normalisht plotësimin e vendeve vakante.

b) Fondi i veçantë i planifikuar të mos përdoret për veprimtari social-kulturore deri më 1 dhjetor 2011.

c) Çdo shpërblim i dhënë nga fondi i veçantë gjatë kësaj periudhe për rezultate të mira në punë, me përjashtim të rasteve kur ligji specifik parashikon ndryshe, të kthehet menjëherë në buxhetin e njësisë shpenzuese.

ç) Orët e punës, të kryera mbi kohën normale të punës, për punonjësit e administratës, të konvertohen vetëm në orë/ditë pushimi, ndërsa për punonjësit, që marrin pjesë në shërbime operacionale dhe, kur nuk është i mundur konvertimi i tyre në orë/ditë pushimi, të konvertohen me pagesë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

d) Në buxhetin e vitit 2011 nuk do të lejohet asnjë pagesë për ditët e pushimit vjetor të pakryer në vitin 2010. Çdo pagesë e kryer për këtë qëllim të kthehet në buxhetin e njësisë shpenzuese dhe ditët e pushimit vjetor të vitit 2010 të riskedulohen, duke vendosur kryerjen e këtyre pushimeve brenda vitit 2011.

Ngarkohen strukturat përkatëse audituese të njësive të qeverisjes së përgjithshme të verifikojnë shkeljet e rregullave, sipas shkronjave “c”, “ç” dhe “d” të pikës 1 dhe të nxjerrin aktet përkatëse për zhvendimin e buxhetit dhe marrjen e masave administrative për nëpunësin autorizues e zbatues. Brenda tre muajve nga data e daljes së këtij vendimi, drejtoritë e auditit të ministrive dhe institucioneve qendrore të raportojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Auditit në Ministrinë e Financave, për zbatimin e masave të mësipërme.

2. Të gjitha fondet buxhetore, që i nënshtrohen procedurave të prokurimit publik, të cilat deri më 1 gusht 2011 rezultojnë të paprokuruar, të bllokohen. Në kuptim të këtij vendimi, fonde të paprokuruar të vlerësohen ato fonde, për të cilat deri më 1 gusht nuk është lidhur kontratë. Përfshihen nga ky rregull fondet buxhetore që shkojnë për shërbimin e ushqimit apo medikamenteve në ato njësi shpenzuese, në të cilat ekziston ky shërbim, fondet për shpenzime kapitale, të cilat nuk janë objekt prokurimi, financimet e huaja dhe fondet përkatëse për kosto lokale dhe detyrime tatimore. Ministri i Financave mund të lejojë vazhdimin e procedurave të prokurimit në raste tepër specifike apo emergjente.

3. Trajnimet jashtë vendit për nëpunësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme, të parashikuara për t’u mbuluar me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2011, bllokohen.

4. Shpenzimet për udhëtim e dieta jashtë vendit, për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të reduktohen duke përfshirë vetëm udhëtime të rëndësishme të veçantë dhe vetëm për një numër të kufizuar punonjësish. Në çdo rast, për kryerjen e këtyre udhëtimeve të merret miratimi i

ministrit/titullarit të institucionit qendror.

5. Ngarkohen të gjitha institucionet e njësisë të qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha